

“KOS do të kontrollojë shumicën e ministrive”



Analisti politik Zlatko Vujović konsideron se Kisha ortodokse serbe – KOS, do të kontrollojë pjesën më të madhe të dikastereve në Qeverinë e re , përbërjen e të cilës e ka propozuar dje mandatarin Krivokapiq. Përveç Kishës ortodokse serbe, në Qeveri, siç konsideron ai do të jenë edhe individë nga Lëvizja qytetare URA. Ai ka theksuar se shumica e kandidatëve të cilët i ka propozuar Krivokapiq për opinionin janë të pa njohur .“Më duket se zgjedhja e kësaj Qeverie është e tillë që do të kemi një Qeveri të Kishës ortodokse serbe dhe Qeverinë e URA-s. Ka ndodhur që partitë të cilat kanë fituar përkrahje të konsiderueshme të qytetarëve, siç është koalicioni i Frontit Demokratik dhe i demokratëve kanë mbetur pa anëtarë të vetë në Qeveri dhe kjo është absurde në një sistem parlamentarë”, ka theksuar Vujović për TVMZ. Ai ka shtuar se Qeveria e re nuk është në tërësi Qeveri e ekspertëve dhe sikur në të të jetë lideri i URA-s mund të shtrohet pyetja , siç ka theksuar ai , pse nga politikanët të jetë vetëm Dritan Abazović. Kontestuese është edhe fakti se në Qeveri nuk janë të përfaqësuar popujt pakicë, gjë që , siç ka shtuar , nuk ka ndodhur deri me tani. Vujović ka përkujtuar se Qeverinë e re mund ta lejojë ose ta votojë vetëm një deputet në Parlament.

